

Gripi i Lukthit dhe i Zorrëve (GLZ)

Çka është një GLZ?

GLZ është një sëmundje e shpeshtë, dhe ajo mund të paraqitet në çdo stinë të vitit. Ajo më së shpeshti shkaktohet përmes një infeksioni viral. Antibiotikët, ashtu sikurse te gripi i vërtet, nuk ndihmojnë, pasi që ata nuk kanë efekt në viruse.

Si zhvillohet një GLZ?

Vjen deri te vjellja dhe shkuarja e barkut. Mund të vjen edhe deri te ethet, zënia e hundës dhe kollitja. Disa fëmijë mund të kenë dhimbje të forta barku. Viruset shumohen në zorrë dhe dalin jashtë me jashtëqitje. Atëherë kur imuniteti, si mbrojtje, është zhvilluar kundër këtyre viruseve, sëmundja është mposhtur. Kjo gjendje rregullisht vazhdon disa ditë, por mund të zgjasë një javë apo më tepër.

Si trajtohet një GLZ?

Më e rëndësishmja është, që fëmija i juaj të pi në masë të mjaftueshme, që të mos vjen deri te dehidratizimi. Para të gjithëve, të rrezikuara janë foshnjat.

- Ofroni fëmijës shpesh sasi të vogla për pirje, në raste të dhëna një gllënjë apo një lugë çdo 5 – 10 min. Bëni këtë edhe nëse fëmija e vjellë. Shënoni me kujdes, se sa pinë fëmija juaj.
- Nëse fëmija është ende në gji, vazhdoni thjesht më tutje dhe më shpesh. Ju guxonin të i jepni edhe tretje të elektroliteve si shtesë me shishe.
- Tretjet e elektroliteve si Normolyto-ral® apo Oralpädon® janë ideale, pasi që ato përmbajnë kripëra dhe sheqere të trupit Ato mund të blihen pa recetë në secilën barnatore apo drogeri.
- Nëse fëmija juaj e refuzon tretjen e elektroliteve, ju mund të e përzieni me pijen e tij të preferuar.

Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni për këshilla: +41 58 387 78 80

(Vazhdim: Trajtimi i një GLZ)

Ju mund të i jepni edhe lëngje të fryteve apo të ëmbla të tretura me ujë (1 gotë me 4 gota ujë). Pijet me përmbajtje qumështi nuk janë ideale, por të lejuara nëse ato janë lëngjet e vetme të cilat fëmija juaj i pranon të i pijë. Edhe ato duhet të treten 1:1 me ujë.

- Fëmija nuk duhet të haj gjithsesi, porse guxon të provoj çka të donë, çka i ka ëndja. Ideale janë shkopinj të me kripë, bananet, peksimadhet dhe orizi.
- Te ngërçi i barkut apo vjellja mund të provohet ndonjë medikament kundër ngërçeve si Buscopan Rapo, ndonjë kundër vjelljes si p.sh. Itinerol B6R. Për fat të keq te fëmijët këto shpesh nuk kanë efekt. Mjetet e ndalimit të bark qitjes si ImodiumR nuk guxojnë të ju jepen fëmijëve, ato zgjasin kohën e bark qitjes dhe çojnë edhe deri te çrregullimi i zorrëve.

Kur e kërkoj unë ndihmën e mjekut?

- Në rast të refuzimit absolut të pirjes apo kur fëmija është lodhur tepër, bile edhe për të pirë.
- Te shenjat e dehidratizimit: Kur nuk i rrjedhin as lotët më, më pak se 4 pelena të lagështa në ditë (mund të jenë edhe më pak të lagështa se zakonisht), apatik (nuk ka më dëshirë as të luaj)
- Në rast të simptomave jo të rëndomta s vetëm vjellje më gjatë se dy ditë, vjellje e gjelbër apo me gjak apo jashtëqitje me gjak
- Pranë GLZ-së, i cili zgjatë më tepër se disa ditë pa përmirësim, sidomos te foshnjat
- Tek fëmijët në 3 muajsh si të ju fillojnë ethet apo vjellja dhe/apo shkuarja e barkut dhe ju zgjatë më tepër se disa orë.
- Çdo kohë, kur ju keni përshtypjen, që gjendja e fëmijës tuaj po keqësohet